

Për një sistem të ri zgjedhor në Kosovë – me zona zgjedhore (botuar në "Koha Ditore" më 17 nëntor 2011)

Edhe pse procesi i përzgjedhjes ose i dizajnit të një sistemi zgjedhor është politik, ai nuk duhet të jetë viktimë (sakrificë) e kalkulimeve afatshkurta politike. Kosova ka një sistem zgjedhor proporcional me një zonë të vetme zgjedhore, me lista të hapura, me prag zgjedhor prej 5% për subjektet politike shqiptare, me kuotë gjinore, dhe me vende të garantuara për minoritetet.

Ekziston një përpjekje që ndryshimet aktuale të sistemit zgjedhor në Kosovë të përdoren për ta mjegulluar krimin e organizuar zgjedhor të para një viti. Kjo përpjekje nuk duhet të na largojë vëmendjen nga fakti se, vitin e kaluar nuk ishte problem themelor sistemi zgjedhor, por themel i problemit ishin parregullsitë në implementimin e sistemit zgjedhor. Më vonë, është bërë problem edhe mos gjykimi i personave përgjegjës, pikërisht për ato parregullsi, në masën dhe nivelin e duhur.

Defektet në zgjedhjet e fundit ishin të shumta, të natyrës teknike dhe ligjore-përmbajtësore, si: votimi i shumëfishtë, prishja e fletëvotimeve, ndërrimi i kutive, kërcënimet e presionet, madje edhe blerja e votës. Në zgjedhjet e fundit u shkel parimi i kushtetues, i cili garanton votën personale, të barabartë, të lirë dhe të fshehtë.

Sidoqoftë, tash ka filluar procesi i ndryshimit të vet sistemit zgjedhor dhe jo vetëm i administrimit të tij. Përcaktimi për një sistem zgjedhor ka peshë të jashtëzakonshme për shoqërinë tonë dhe do të ketë konsekuenca thelbësore në organizimin e jetës institucionale-politike ndër ne.

Parametrat e demokracisë zgjedhore

Cilido sistem zgjedhor, asnjëherë nuk mund t'i inkorporojë të gjitha kriteret ose aspiratat legjitime të një shoqërie ose shteti demokratik. Thënë ndryshe, nuk ka sistem perfekt zgjedhor. Megjithatë, një sistem zgjedhor mund t'i përshtatet një shoqërie më shumë ose më pak, varësisht se a promovohen apo jo, institucione shtetërore demokratike, stabile, dhe në shërbim të qytetarëve, por edhe fleksibile, për një shoqëri që evoluon përherë.

Parametra të tjerë bazë, që duhet pasur parasysh, janë edhe përfaqësimi i drejtë me bazë gjithëpërfshirëse gjeografike, llogaridhënia individuale e deputetëve dhe e tërë Kuvendit, si dhe promovimi i mbikëqyrjes nga opozita dhe qytetarët.

Sistemi zgjedhor duhet ta inkurajojë punën e ligjshme të partive politike. Tek ne është veçanërisht i rëndësishëm demokratizimi dhe profilizimi i partive politike, gjë që do t'i ndihmojë qytetarët t'i artikulojnë kërkesat, t'i ndërtojnë pritjet dhe t'i bëjnë vlerësimet e tyre, për partitë të cilat i votojnë. Deri tash, partitë tona politike, me përjashtime të rralla, janë definuar

kryesisht nga interpretimi i tyre për historinë më të re të Kosovës dhe ofertat e tjera të përgjithësuara, e më pak nga ofertat konkrete për të ardhmen e qytetarit, në ambientet e ndryshme.

Ndërtimi i marrëdhënieve demokratike brenda subjekteve politike është bazë determinuese për të gjitha marrëdhëniet në shoqëri. Duhet spikatur se në zgjedhjet e fundit pati edhe konkurrencë të pandershme brendapartiake, që nuk ishte thjesht sjellje joxhentëllmene, por ishte shkelje flagrante ligjore, e cila, sikurse shkeljet e përmendura në mes të subjekteve politike, nuk u adresua në mënyrë adekuate nga organet kompetente ligjore. Prandaj, sistemi i ri zgjedhor nuk duhet të inkurajojë konkurrencë të pandershme, as brenda subjekteve politike.

Sistemi i ardhshëm zgjedhor, më në fund, nuk duhet të jetë i komplikuar, duhet të inkurajojë pjesëmarrjen e qytetarëve dhe të mundësojë bashkëpunimin e subjekteve të ndryshme, e jo konfrontimin e tyre me çdo kusht.

Adresimi i çështjeve të sipërpërmendura në dritën e një sistemi të ri zgjedhor

Ndarja e Kosovës në zona jo të mëdha zgjedhore, e kombinuar me një sistem të përzier proporcional, i përmbush parametrat bazë të demokracisë zgjedhore të apostrofuara më sipër.

Qartazi, një zonë zgjedhore, si deri tash, qoftë me lista të hapura apo të mbyllura, nuk e siguron as përfaqësimin e drejtë gjeografik dhe as llogaridhënien e individëve të zgjedhur, si dhe nuk e inkurajon demokratizimin e partive politike.

Edhe kur kemi më shumë se një zonë zgjedhore, nëse zonat janë të mëdha, atëherë dështohet në përmbushjen parametrave të përmendur. Për më shumë, zonat e mëdha zgjedhore do t'i thëllonin ndasitë rajonale, të cilat veç e rëndojnë shoqërinë tonë. Do përmendur se, numri i zonave të propozuara nganjëherë është bazuar në numrin e qendrave të regjistrimit të veturave ose në numrin e gjykatave të qarkut, gjë që nuk ka mjaftuar për një argumentim serioz.

Nga ana tjetër, nëse zonat zgjedhore bazohen në kufijtë e komunave të Kosovës, atëherë arrihet në shkallë të kënaqshme përmbushja e kriterëve të dhëna zgjedhore. Problem i vetëm mund të ishin komunat me numër të vogël të banorëve (respektivisht votuesve), të cilat teorikisht nuk do të kishin asnjë ulëse. Mirëpo, edhe ky problem evitohet mjaft lehtë, me sistemin zgjedhor të propozuar më poshtë.

Detajet e sistemit zgjedhor të propozuar

Së pari disa fjalë për statistikën që përdoren. Pikënisje mund të jetë numri i banorëve ose numri i votuesve. Të dy përcaktimet kanë kuptim, sepse deputetët i përfaqësojnë të gjithë qytetarët e zonës zgjedhore (në rastin e parë) ose sepse ata zgjedhen nga votuesit e asaj zone (në rastin e dytë). Rasti i parë, sipas numrit të votuesve, mund të rezultojë kështu:

Secilës komunë, varësisht nga numri i votuesve, i caktohet numri i ulëseve. (Për ekspertët:

Caktimi mund të bëhet me rrumbullaksim ose metoda të tjera p.sh. Saint-Laguë.) Nga ky proces, komunat e vogla do të diskriminoheshin nëse paraprakisht nuk do t'i bashkonim me komuna më të mëdha fqinje. Ggjatë përcaktimit të zonave, përparësi duhet t'u jepet komunave që kanë ose kanë pasur lidhje administrative apo lidhje të natyrshme gjeografike, p.sh. Prishtina dhe Graçanica të përbëjnë një zonë zgjedhore, Prizreni dhe Mamusha, Deçani dhe Juniku, e kështu me radhë. Caktimi i tillë i zonave zgjedhore do të përbënte vendim politik jokontraverz dhe do të kishte nevojë për rishqyrtim të numrit të ulëseve të ndara për zonat zgjedhore, në çdo 10 vjetë ose kurdo që të bëhen regjistrimet periodike të popullsisë.

Nëse në Kuvendin e Kosovës do të zgjedheshin gjithsej 70 deputetë drejtpërdrejt nga zonat zgjedhore, atëherë nga një kalkulim i thjeshtë, mund të vërehet se numri i zonave zgjedhore në këtë mënyrë do të ishte 26, kurse numri i ulëseve për zonë do të ishte: Prishtinë (8), Prizren (6), Gjakovë (4), Mitrovicë (4), Pejë (4), Ferizaj (4), Gjilan (4), Podujevë (3), Vushtrri (3), Suharekë (2),..., Obliq (1), Shtime (1). Një ndarje e tillë zonale do të kishte devijueshmëri të pranueshme statistikore të mesatares së numrit të votuesve për një ulëse.

Në secilën zonë ka disa mundësi të votimit, por më e preferueshme është metoda e listave të hapura, ku qytetarët mund të votojnë për kandidatin (në rastin e zonave zgjedhore me një ulëse) ose kandidatët e preferuar nga i njëjti subjekt politik. Pra, qytetari voton për subjektin politik dhe kandidatin/kandidatët nga i njëjti subjekt. (Kuptohet, këtu ekzistojnë disa opsione ose kombinime: mundësia e listave të mbyllura, që nuk do t'i adresonte parametrat e demokracisë zgjedhore të paraqitura më lartë, pastaj mundësia që të votohet për kandidatë dhe për parti ndaras, gjë që do të ishte më vështirë e pranueshme për partitë politike në Kosovë, etj.)

Ulëset e tjera, gjithsej 50, ndahen për subjekte politike sipas sistemit proporcional (p.sh. Saint-Laguë), në varësi të votave të fituara nga subjektet politike në nivel vendi. Ulëset e proporcionalit për secilin subjekt politik mund të ndahen në atë mënyrë që përparësi t'i jepet kandidatëve të cilët kanë fituar më së shumti vota e që kanë mbetur jashtë Kuvendit, ose sipas një liste të ranguar të kandidatëve, të dorëzuar më herët nga subjekti politik.

Nëse vendoset të mbahet pragu zgjedhor prej 5%, ai mund të mbahet edhe me këtë sistem. Po ashtu, për shkak të pjesës proporcionale, mundësohet edhe mbajtja e kuotës gjinore si dhe e ulëseve të garantuara (20) për minoritetet. Do të ishte ide e mirë që pas dy mandatave të rishqyrtoheshin këto provizione dhe mbipërfaqësimet të cilat nganjëherë e kanë efektin e kundërt me atë të dëshiruar, kuptohet me vullnet valid politik të të gjitha subjekteve strukturale.

Natyrisht, mbeten disa detaje që duhen përcaktuar, se çfarë ndodh kur të mbetet një ulëse e zbrazët, a bëhet zëvendësimi nga anëtarë i të njëjtit subjekt në zonën e njëjtë zgjedhore, apo zëvendësohet nga lista e parapërcaktuar nga subjekti zgjedhor, etj.

Ky sistem, përveç përmbushjes së parametrave demokratik, e bën më të lehtë pranueshmërinë e rezultateve të zgjedhjeve, sepse kandidatët e kanë më të lehtë të informohen për

(pa)rregullsitë në zonat e tyre respektive. Njëkohësisht, falë pjesës proporcionale, roli i partive politike nuk zbehet, edhe pse sistemi ua mundëson edhe kandidatëve ta pavarur të kenë mundësi për të fituar nëpër zona zgjedhore. Pjesa proporcionale, po ashtu siguron që vota e askujt të mos të humbet, edhe nëse në zonën e votuesit nuk fitojnë kandidatët e tyre të preferuar.

Në fund, siç është theksuar, nuk ka sistem perfekt zgjedhor, dhe në zgjedhjet 2010, problem më i madh ishin parregullsitë në implementimin e sistemit zgjedhor, se sa vet sistemi zgjedhor. Mirëpo, meqë ka filluar reforma zgjedhore, ia vlen të merremi seriozisht me të, duke e shfrytëzuar rastin dhe kapacitetet për t'i vënë bazat e shëndosha demokratike të sistemit politik.

Përshkrimi i mësipërm i sistemit të propozuar zgjedhor ishte i shkurtër dhe i përgjithësuar, por duhet kuptuar si kontura kryesore fillestare, për gjetjen e zgjidhjeve të përshtatshme për vendin tonë.